

Gazeta: Ju e nisni librin tuaj “Rivendosja e otomanëve. Moderniteti alternativ në Ballkan 1800 - 1912” me një fotografi – atë të Ismajl Qemajlit teksa qëndron i vetëm në ballkon më 28 nëntor 1913, në përvjetorin e parë të pavarësisë së Shqipërisë. Më pastaj tregoni se kjo fotografi është manipuluar nga regjimi i Enver Hoxhës, i cili e “fshiu një klasë politike të tërë nga historia e Shqipërisë”, pasi që në fakt kishim të bëjmë me një foto në të cilën Ismajl Qemajli nuk qëndronte i vetëm, por me së paku një duzinë anëtarësh të kabinetit qeveritar të tij. Përse e ndërmoi këtë veprim Enver Hoxha, çka deshi të arrinte me manipulimin e kësaj fotografie?

I. Blumi: Nevoja e regjimeve “revolucionare” për të kontrolluar historinë duke e rishikuar atë nënkupton vënien në spikamë të personazheve të cilët ndërlidhen me shfaqjen e partisë në pushtet. Ky kontroll gjithashtu kërkon shlyerjen e kontributit të disa personazheve tjera. Fotografitë shpesh janë përdorur për tu shërbyer interesave propaganduese të regjimit në pushtet duke bërë ndërhyrje në to. Ajo që është interesante lidhur me regjimin e Hoxhës është se ai në fakt i manipuloi fotografitë që tanimë ishin të njohura për njerëzit dhe bënte me to ngjashëm si bëri me këtë fotografi ikonike të historisë së hershme të Shqipërisë postotomane.

Njëkohësisht, regjimi i Enver Hoxhës shkatërroi ndërtesa, varreza, biblioteka dhe zhduku arkiva të tërë. Andaj, mund të spekulohet se brutaliteti i këtij ndryshimi eklatant të një ngjarjeje historike përbën një akt të manipulimit të hapur; nëse fotografia shikohet me kujdes, ende mund të shihen gjurmat e atyre që u shlyen nga fotografia e retushuar. Arsye e kësaj mund të jetë mbase edhe paaftësia e autorit të retushimit. Por, ka mundësi që regjimi i cili ishte i njohur për dhunën që ushtronte mbi kundërshtarët e vet t’i ketë shfrytëzuar fotografitë e ngjashme edhe për t’i frikësuar oponentët potencialë. Largimi i këtyre burrave nga fotografia në mënyrë kaq të vrazhdë thuhet të bëhet për t’ua rikujtuar të gjithëve se regjimi mund ta shlyente këdo nga historia, e madje edhe nga a tashmja. Kjo pak a shumë funksionon si një akt i përhershëm frikësimi, njësoj sikur kur njerëzit që vareshin nga shteti liheshin me ditë të tëra në sheshin qendror të qytetit, në mënyrë që t’ua dëshmonin të gjithëve haptas se shteti kishte fuqinë për t’ia bërë të njëjtën gjë kujtdo.

Aktet e tilla janë tipike dhe kanë histori të gjatë në Europë; shembja simbolike dhe publike e monumenteve dhe statujave të pushtetarëve të mëparshëm dhe ngritja e monumenteve të reja me të cilat simbolizohet rendi i ri, si dhe shfrytëzimi i këtyre statujave/monumenteve të reja për të maskuar vrasjet masive të kryera nuk janë vepra vetëm të Enver Hoxhës apo Josif Stalinit por janë mënyra të shpeshta se si e tregojmë historinë edhe sot. Andaj, arsyeja përse e kam shfrytëzuar këtë foto është që t’ua rikujtoj lexuesve të librit se shqiptarët, sikur edhe të gjithë popujt e Ballkanit, për një shekull të tërë janë munduar që të retushojmë të kaluarën kolektive otomane. Natyrisht, e tërë e kaluara e Shqipërisë është manipuluar për t’i shërbyer regjimeve të ndryshme që janë ndërruar përgjatë shekullit të njëzetë, përfshirë këtu epokën antike, mesjetën dhe zhvillimet gjatë Luftës së Dytë Botërore. Manipulimet jo-legjitime të së kaluarës nga regjimi i Hoxhës përmes përfshirjes selektive të disa fakteve kyçe janë të barabarta me përpjekjet e kohës sonë për të injoruar e madje

edhe për të retushuar në mënyrë të hapur disa segmente të rëndësishme të së kaluarës sonë, në veçanti të asaj gjatë periudhës otomane.

Gazeta: Më tej, në librin tuaj ju thoni se Enver Hoxha nuk ishte i vetmi që u përpoq që të manipulojë kujtesën kombëtare “duke i larguar të gjitha referencat e trashëgimisë otomane të cilat në foto ishin tërësisht evidente”. A mund ta ilustroni këtë për neve: cilat janë disa nga këto manipulime të historisë së kësaj periudhe të cilat po u shërbejnë shqiptarëve të rinj pas viteve të 90-ta përmes librave të historisë dhe burimeve tjera, e të cilat realisht nuk janë të vërteta?

I. Blumi: E pavërteta më e shpeshtë lidhur me historinë shqiptare gjatë epokës otomane ka të bëjë me paraqitjen e marrëdhënies së shqiptarëve me otomanët në frymë konfrontimi. “Shqiptarët” kolektivisht nuk i kanë kaluar jetët e tyre duke u “rezistuar” përjetësisht forcave “okupuese turke”. Kjo përbën një paraqitje tërësisht të gabuar të një historie pothuajse 600-vjeçare gjatë së cilës të gjithë otomanët (përfshirë shqiptarët - myslimanë, të krishterë dhe çifutë) bashkëjetonin në mënyra që konsiderohen të “pamundura” sipas kornizave kufizuese ideologjike dhe sociologjike përmes së cilave ne sot i studiojmë marrëdhëniet njerëzore. Karakterizimi i lëvizjeve lokale dhe regjionale për marrje të pushtetit përgjatë shekujve si lëvizje etnike shpie tek keqinterpretimi i faktorëve që ndikonin në marrëdhëniet mes grupeve të ndryshme në këtë shoqëri heterogjene paramoderne.

Në këtë aspekt, mitologjitë nacionaliste të shqiptarëve modernë (ngjashëm me ato të grekëve, turqve, bullgarëve, serbëve e boshnjakëve) vazhdimisht i pozicionojnë shqiptarët në një njësi unike, politike, kulturore e rrjedhimisht edhe etnike e kombëtare që mbulon një territor të gjerë gjeografik. Kjo është mbase ideja e gabuar që më së vështiri mund të sfidohet, pasi që miti i kahmotshëm i popujve dhe kombeve i përgjigjet politikave moderne të sotme. Historia e shteteve moderne evropiane kërkon formulimet e tilla mbi sovranitetin e komuniteteve që bashkohen me një gjuhë, fe dhe/ose kulturë të përbashkët. Por, zhvillime të tilla nuk kishte para Luftës së Parë Botërore. Pika më të shpeshta reference për të dalluar dhe formësuar bashkësitë e caktuara ishin faktorët regionalë, fetarë, klasorë, tregtarë dhe jo pretendimet etnike e kombëtare, kriteret e së cilave sfidohen edhe sot. Për më tepër, të mos harrojmë se të gjithë qytetarët e perandorisë ishin subjekte otomane. Kjo do të thotë se ata me origjinë shqiptare, sikur edhe serbët, turqit, kurdët, arabët, apo të krishterët, myslimanët, çifutët, ishin pjesë e klasës udhëheqëse otomane. Në fakt, nga tokat shqiptare kishte disproporcionalisht më shumë figura që u bënë pjesë e elitës politike, ushtarake, fetare e shpesh edhe kulturore të kësaj perandorie të madhe.

Gjatë ligjërimit të historisë moderne të Ballkanit/Lindjes së Mesme/Evropës unë shpesh kërkoj nga studentët që të mendojnë se çfarë roli të rëndësishëm vazhdon të luajnë regjionalizmat në shoqëri – martesë, afarizëm ose organizim politik. Në një vend si Kosova kjo është evidente në çdo aspekt. Për shembull, shumica e kosovarëve/shqiptarëve nuk hezitojnë që të diskriminojnë njëri-tjetrin në bazë të

originës së rajonit apo fshatit/qytetit nga i cili vijnë e madje edhe në bazë të originës familjare.

Nëse dikush mendon se regjionalizmi nuk përbën problem në Kosovë - shikoni besnikërinë që gëzojnë partitë politike. Shihni se sa është e afërt lidhje mes qarqeve të brendshme të partive politike në vend dhe regjioneve nga të cilat vijnë këto qarqe. Këto lidhje luanin rol po aq të rëndësishëm e madje edhe më shkatërrimtar në Shqipëri gjatë pushtetit të Hoxhës/elitës së jugut. Ky grup përbëhej kryesisht nga pjesëtarë (shpesh edhe me trashëgimi kulturore joshqiptare) të elitës së jugut e cila e copëtoi tërësisht kulturën e Malësisë, imponoi migrime të dhunshme, këmbime të popullatës dhe përfundimisht shkatërrimin e jetës fetare, kryesisht të fokusuar në Shqipërinë veriore dhe të mesme.

Siç thuhet edhe në libër, regjionalizmi ishte tejet i rëndësishëm për ngjitjen e figurave prominente shqiptare në botën otomane. Me disa përjashtime, në botën otomane pasuroheshin dhe afirmoheshin shqiptarët e jugut, të cilët kishin lidhje me familjet e mëdha të regjioneve të Korçës, Janinës e Manastirit. Në fakt është mbresëlënëse ky aspekt i historisë otomane që është anashkaluar në mënyrë anakronike gjatë shekullit XX, me konkretisht pas fillimit të mbizotërimit të kategorive etnike dhe kombëtare pas Luftës së Parë Botërore. Tregimi otoman nuk është tregim shqiptar, turk, arab, armen etj, por një tregim regjional në të cilin disa grupe të caktuara njerëzish, në momente dhe vende të caktuara, arrinin të fitonin famë dhe prapa tyre të sjellin pjesëtarë nga regjioni i tyre e ta integronin atë në burokracinë shtetërore otomane. Shumë njerëz/familje nga Shqipëria e sotme u integruan plotësisht në strukturat politike, fetare, ushtarake dhe ekonomike të shoqërisë otomane që nga fillimi i shekullit XV. Edhe pse na thuhet se 'okupimi otoman' (që gabimisht quhet "okupimi turk") e ka shkatërruar shoqërinë shqiptare, duhet të kujtojmë se deri në shekullin XIX shqiptarët luanin rol kyç në zgjerimin e pushtetit otoman deri në Afrikë dhe vendet e Oqeanit Indian. Mehmet Ali nga Kavalla (lideri shqiptar toskë që udhëhoqi Egjiptin në emër të Perandorisë Otomane, 1805-1840), pak a shumë bëri që Perandoria Otomane të bëhej perandori afrikane duke e shtrirë deri në Etiopi, Ugandë dhe Jemen. Ngjashëm me figurat e dalluara shqiptare para tij, Mehmet Ali Pasha solli familjen dhe aleatët e tij në zemrën e shoqërisë egjiptiane, e cila në shekullin XIX ishte pjesë e botës mesdhetare dhe përbënte një shoqëri që bazohej në rrjetëzime mes sicilianëve, maltezëve, toskëve, jonianëve, kretanëve dhe shqiptarëve që përfaqësonin perandorinë. Të tilla ishin edhe rrjetëzimet e familjes së Ismajl Qemajlit, e cila lulëzoi si familje otomane, të Frashërve, të Pashko Vasës i cili në emër të Sulltanit udhëhoqi Libanin, si dhe shumë figurave tjera të rëndësishme të cilat ishin kyçe për themelimin e sistemit modern politik në fillim të shekullit XX, përfshirë edhe vetë Ataturkun.

Këto nuanca humbin në librat shkollorë që imponojnë një model të shoqërisë moderne nga shekulli XX për interpretimin e një epoke kur shoqëritë ishin shumë më provinciale, regjionale dhe të ngushta. Vetë prania e regjionalizmave, dialekteve, gjesteve, e madje edhe e batutave për njëri-tjetrin dëshmon se identiteti i qartë shqiptar i kosovarëve është ende i pakapshëm. Forcat e nevojshme për t'i afruar

këto komunitete të ndryshme thjeshtë nuk kanë ekzistuar në historinë e Perandorisë Otomane, edhe kur në mesin e shekullit XIX u bënë përpjekje për të krijuar identitete moderne politike dhe shoqërore, ato nuk shkonin në drejtim të krijimit të popullit shqiptar, grek apo bullgar, por të qytetarëve otomanë. Kjo duhet theksuar nëpër shkolla sot.

Pranimi i këtij fakti do të ndihmonte që të kuptojmë forcat që manipulojnë nocionin simplistik të identitetit sociopolitik. Ne jemi më dinamik dhe kompleks dhe nuk do duhej t'i ishim nënshtruar logjikës së populli i Kosovës është shoqëruar dhe organizuar në vija etnike shqiptare/serbe/turke. Ne si shoqëri kemi vuajtur si rezultat i kësaj. Ky është aspekti më i neglizhuar i së kaluarës të cilin librat shkollorë nuk do ta trajtojnë.

Gazeta: Libri juaj pretendon se heronjtë shqiptarë, siç janë Ali Pashë Tepelena dhe Isa Boletini, nuk e kishin brengë kryesore ndërtimin e shtetit shqiptar por sigurimin e pushtetit të tyre përmes gëzimit të përkrahjes së të gjitha etnive që jetonin në vilajetin apo regjionin e tyre, duke u prezantuar para Perandorisë Otomane si figura të rëndësishme për regjionin dhe jo si udhëheqës shqiptarë. Si mund të ndodhë që shtetësia dhe krijimi i shtetit nuk ishin të rëndësishme për ta, si mund ta sqaroni këtë?

I. Blumi: Ne i kemi dhënë tepër peshë interpretuese akteve të disa burrave botët e së cilëve ende nuk kishin parë ndarje sipas vijave etnike e kombëtare. Nocioni i të qenit pjesëtar i një komuniteti që organizohej ekskluzivisht në bazë të gjuhës apo fesë përbën një paraqitje tërësisht të gabuar të historisë së Ballkanit para vitit 1912. Kjo është në veçanti e pavend kur shtjellojmë projektet e mrekullueshme e të ndërlikuara të epokës paramoderne të figurave si Ali Pashë Tepelena, ambiciet e të cilit ishin tërësisht brenda kornizave të kontekstit otoman gjatë asaj periudhe të ndryshimit të shekujve e që e bënë atë një nga baballarët e shtetit "grek", jo për shkak të politikës së identitetit, por për shkak të institucioneve që i mobilizoi dhe aleancave politike që i krijoi. Sferat e ndikimit të tij kulturor, ushtarak, ekonomik dhe politik nuk ishin të drejtuara në veri (d.m.th. në Shkodër e Prizren) po në pjesën jugore. Megjithatë, marrë parasysh prejardhjen e përzier të tij (që përfshin edhe prejardhjen shqiptare) nga ne sot kërkohet që veprimet e tij t'i interpretojmë sipas përkufizimeve të periudhës pas Luftës së Parë Botërore. Ky përdorim i thjeshtuar i gjuhës të cilën dyshoj se e kanë shfrytëzuar palë të ndryshme interesi për kohë të gjatë, përfshirë Greqinë dhe Serbinë, mund të konsiderohet anakronizëm. Vërtet është lehtë që nocionet e tilla të manipulohen duke krijuar ndërlidhje tërësisht të paqena për epokën tonë.

Tregimi i Boletinit është një shembull tjetër i asaj se si ideologët e epokës post-otomane janë përpjekur që t'a absorbojnë dhe riformulojnë rëndësinë e veprimeve të tij jashtë kontekstit në të cilin Boletini jetonte e që ndryshonte vazhdimisht. Ai vepronte në një kontekst regjional që përfshinte edhe shtetin e Serbisë që rishtas ishte zgjeruar dhe përfshinte pjesë të territorit që banohej nga komuniteti i tij dhe me të cilin bëheshin këmbime tregtare. Në fakt, Boletini u dallua për shkak të

aftësisë së tij për të shfrytëzuar faktin se jetonte buzë kufirit që ndante Kosovën otomane nga Serbia e cila ishte në ekspansion. Aftësia e tij për të bërë biznes me serbët otomanë, shqiptarët otomanë dhe ata serbë e shqiptarë që jetonin në krahinën e Nishit që tani bënte pjesë në shtetin serb, nënkuptonte kontrabandimin e ushqimit dhe armëve nga dhe prej këtyre territoreve. Kjo e bëri të famshëm atë por eventualisht kjo e solli deri tek arrestimi i tij e më vonë radhitja e tij si pjesëtar i gardës së pallatit të Sulltanit të Perandorisë Otomane në Stamboll.

Gazeta: Në botën moderne në të cilën jetojmë, besojmë se multi-etniciteti është koncept që na është imponuar pas vitit 45, që është sfiduar me luftëra etnike dhe që ka kulmuar me shkatërrimin e ish-Jugosllavisë e që shumica e historianëve të vendit dhe ndërkombëtarë ia mveshin “urrejtjes etnike shekullore”. Por, në librin tuaj në fakt pretendohet se Ballkani ka histori 500-vjeçare të multietnicitetit nën Perandorinë Otomane në të cilën etnicitetet ishte tejet fleksibile, njerëzit ishin poliglotë dhe nuk demonstroi besnikëri ndaj kombësive të tyre. Atëherë, si e përkufizonin përkatësinë e tyre popujt që jetonin në Ballkan gjatë periudhës mes shekujve XV dhe XIX? Si funksionoi kjo përgjatë kësaj periudhe por jo edhe gjatë të viteve të 90-ta të shekullit të kaluar?

L.Blumi: Kjo është një çështje kyçe që i brengosë shoqëritë komplekse. Nuk është me rëndësi vetë diversiteti por mënyra se si diversiteti është shfrytëzuar nga interesa të ndryshëm. Nuk është e vështirë për ata që zotërojnë resurset dhe kanë pushtetin që të dënojnë apo të favorizojnë disa grupe tiparet e të cilave bëhen “etnike” ose “kombëtare” vetëm atëherë kur protagonistë e bëjnë këtë dallim qoftë në mënyrë juridike apo si pjesë e proceseve të negociuara në qarqe diplomatike. Kapacitetet e shtetit otoman për të bërë këtë, e madje edhe vullneti për të, është shumë i ndryshëm nga mënyra në të cilën u krijuan “dallimet” të cilat më pas u eksploatuan nga shtetet e shekullit XX. Në këtë periudhë procesi i krijimit të shteteve moderne përqendrohej në disa konstituencia më të ngushta, të cilat nuk kishin nevojë që ta ndajnë fuqinë e pushtetin me ata që ishin përjashtuar nga ky proces i vënies së emrave. Në të kaluarën, pasuria dhe pushteti ndaheshin mes komuniteteve të ndryshme për shkak të aftësisë që kishin për t’i rezistuar dhunshëm proceseve tjera. Kjo në shumë aspekte përbënte një mënyrë ekspeditive, në kuptim ekonomik e rrjedhimisht edhe politik, për të menaxhuar shoqëri komplekse. Ajo që ndryshoi ishin kapacitetet e disa entiteteve të caktuara për të grumbulluar fuqi njerëzore dhe për t’i aftësuar ato, gjë që rezultoi me përqendrimin e dhunës në duart e tyre.

Kjo përbënte një hap të rëndësishëm përpara në raportin e forcave e që kulmoi me krijimin e shteteve moderne. Ngjashëm me shoqëritë tjera të shekullit XIX, në historinë otomane ka shembuj të qartë të përpjekjeve për të centralizuar pushtetin shtetëror, të cilat përfundonin me luftë mes interesave lokale dhe regjionale dhe interesave ekspansionistë të shtetit otoman. Shfrytëzimi i diversitetit të këtyre shoqërive, me fjalë të tjera nxitja e qëllimshme e konkurrencës dhe grindjeve mes grupeve të ndryshme fetare apo mes ‘grupeve etnike’ nuk ishte pjesë e agjendës së

klasës udhëheqëse otomane, e cila shpresonte se do të zaptojë dhe inkorporojë në perandorinë e saj edhe territore të ngjashme me ato në të cilat jetonin paraardhësit tonë në Ballkan. Mos harroni, nuk ishte në interesin e otomaneve që perandoria të shpërbëhet që do të thotë se gjëja e fundit që donin të shfaqej ishte ndasia fetare mes popullatës së përzier.

Dallimi mes zgjerimit në territore të reja të perandorive euroatlantike dhe Perandorisë Otomane është se qëllimi i kësaj të fundit ishte, natyrisht me disa përjashtime, që të sigurojë harmoni në viset otomane. Sigurisht, kishte momente kur disa grupe të caktuara kyçe zhvendoseshin në regjione me telashe, siç është transportimi i çeçenëve në Kosovë, apo i refugjatëve nga Nishi pas vitit 1878 kur zgjerimi i Serbisë u pranua formalisht nga Fuqitë e Mëdha. Por, shumë nga këto palë përbëheshin nga popuj të pjesëve të Ballkanit perëndimor. Rrjedhimisht, shumë shqiptarë u transferuan dhe u vendosën në pjesë tjera të Perandorisë Otomane, kryesisht si ushtarë, duke krijuar kështu komunitete të ballkanasve të cilat ende vazhdojnë të ekzistojnë në Algjeri, Tunizi, Egjipt dhe Siri.

Duhet pasur parasysh se Perandoria Otomane ishte kryesisht Perandori Ballkanike. Hapësira e Ballkanit, e cila një kohë të gjatë ka qenë dinamike në kuptimin kulturor dhe e “përzier”, nuk ka mundur të ndahet qartë. Për këtë sot po shkruhen histori revizioniste që sfidojnë edhe nocionet se Bullgaria, Greqia apo Serbia ishin homogjene në fillim të shekullit XX. Ajo që është me rëndësi është të kuptohet se gjatë epokës otomane komunitetet dalloheshin për nga veshja, regjioni apo feja/sekti i tyre, duke mos anashkaluar faktin se feja nuk ka qenë pengesë e ndërveprimit social.

Është gjithashtu me rëndësi të mbahet në mend se konvertimi në komunitete tjera kryhej kryesisht në kuptim fetar dhe grupet e krijuara nuk përbënin grupe etnike. Nëse kjo do të ndodhte, sot shqiptarët nuk do të ekzistonin. Në këtë kuptim, qëndrimet e mia mbi rileximin e poezive të Pashko Vasës apo veprimeve të Sami Frashërit janë kyçe, sepse këta njerëz vepronin në një shoqëri që mbetej tejet e larmishme por edhe e integruar. Bota e tyre otomane ishte kosmopolitane dhe ndarjet që ata shihnin se po krijoheshin përmes politikave manipuluese të Britanisë, Francës, Austrisë, apo Rusisë, e që u shërbenin interesave të këtyre të fundit, i shtyri ata që të promovojnë natyrën gjithëpërfshirëse otomane dhe jo separatizmin etnik-nacional. Kontributit të tyre për shoqërinë otomane dhe shërbimit që ata i kanë bërë shtetit otoman qëllimisht nuk i është kushtuar vëmendje ndaj edhe shkrimet e tyre janë nxjerrë prej kontekstit.

Gazeta: A mund ta ilustroni me disa shembuj se cilat janë çështjet më të rëndësishme lidhur me Kosovën dhe Shqipërinë të cilat historiografia i ka injoruar që nga fundi i Luftës së Parë Botërore? (e di që ju e keni shkruar një libër të tërë në këtë temë, por ju lus që nga libri t’i shkoqitni vetëm disa shembuj).

I.Blumi: Theksimi i marrëdhënieve mes komuniteteve apo përbërjes së komuniteteve, të qenit shqiptar apo ekskluzivisht serb, grek apo turk, nuk përbënte kriter për ndërtimin e shoqërive para Luftës së Parë Botërore. Ngjashëm funksiononte edhe religjioni në Ballkan dhe në botën e Mesdheut lindor. Të mos harrojmë, sllavët, ngjashëm sikur edhe shqiptarët, armenët, arabët dhe turqit, ishin të ndarë në religjione të ndryshme. Ata nuk ishin vetëm katolikë, ortodoksë apo protestantë, por edhe çifutë e myslimanë të shumë radhëve të Sufive dhe me zakone të ndryshme.

Dallimet fetare dhe “etnike” që shprien tek migrimi i dhunshëm ngjanë kur rendi politik otoman u rrëzua dhe u zëvendësua me rende politike që udhëhiqeshin nga shtete më të vogla me interesa strategjike më të ngushta. Këto interesa strategjike ngërthenin mospërfshirjen e konstituencave që më parë ishin autonome apo ekonomikisht të fuqishme (e të cilat edhe vetë përbëheshin nga nëngrupe fetare apo etnike). Rrjedhimisht, Kosova si entitet më i madh i mbetur pas vitit 1878, me Shkupin si kryeqendër administrative, fillimisht u desh të pushtohet nga Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, e më pas të ndahet me dhunë në njësi më të vogla sipas përkatësisë fetare, në të cilat myslimanët kolektivisht identifikoheshin me Turqinë e epokës post-otomane (shumë myslimanë joturkë u dëbuan me dhunë në Anadoll nga vitit 1912 e tutje), katolikët u eliminuan pothuajse tërësisht ndërsa shumë shqiptarë, turq e sllavë të fesë myslimane u konvertuan me dhunë në të krishterë ortodoksë.

Një tjetër mënyrë për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje është që të vëmë në spikamë prapë faktin se gjatë epokës otomane, shqiptarët ishin shumë më të ndarë mes veti. Në fakt, ekziston një kontradiktë e logjikshme nëse ne i lejojmë historianët që të shfrytëzojnë terminologjinë e pas Luftës së Parë Botërore kur flasin për epokën otomane. Kjo është arsyeja përse unë në librin tim shpesh shfrytëzoj termet Gegë dhe Toskë; jo si zëvendësime të një kategorie universale me dy kategori tjera, por me qëllim që thjeshtë të sqaroj se në shoqëritë otomane ka pasur mënyra të caktuara të shoqërimit dhe përjashtimit të cilat strategjikisht injorohen nga historiografia shqiptare.

Kjo ka të bëjë me tensionet që pretendohet se kanë ekzistuar mes “grupeve të ndryshme”. Për shembull, mënyra se si njerëzit ndërvepronin gjatë ditës së tregut, le të themi në Pejë, shpesh përcaktohej nga faktorë që nuk ishin etnikë apo fetarë. Për shembull, sllavët, shqiptarët, turqit dhe të tjerët vazhdimisht tregtonin mallrat e tyre në tregje të tilla; faktor kryesor se me kë do të hynin në marrëdhënie tregtare nuk ishte përkatësia etnike apo fetare por aftësia apo reputacioni kreditor i personit përkatës. Antropologët kanë studiuar gjatë interaksionet mes njerëve në tregje dhe kanë vërejtur se besimi është element kryesor në përcaktimin nëse grupet e ndryshme do të tregtojnë mes veti. Me shfaqjen e shteteve moderne si Serbia, Mali i Zi apo Greqia, në të cilat elitat shtetërore mund të kishin interes për të stigmatizuar ndonjë grup të caktuar që identifikoheshin me përkatësi fetare dhe përmes përdorimit të propagandës të shkatërrojnë me shpejtësi besimin në këtë grup. Gjithashtu, u imponuan ndëshkime për tregtim me komunitete “tjera” apo “armike”, gjë që

kontribuoi në shkatërrimin e shoqërive multi-sekatariane lokale që ekzistonin në Ballkanin otoman.

Gazeta: Është mjaft kontroverse kur shkruani se Isa Boletini ishte njëkohësisht njeri “që ndërtonte lidhje në Stamboll që ishin të rralla për kosovarë me origjinë të tillë sociale; shembull tipik i ‘njeriut të egër’ përparimit të të cilit i frikësohej elita toske otomane (faqe 146), por në të njëjtën kohë në libër tregoni se Boletini ishte kontrabandues i armëve për serbët që jetonin në Kosovë (nëse e kam kuptuar mirë?! Në botën moderne kjo do përbënte një paradoks.

I. Blumi: Nuk jam i sigurt se çfarë ka paradoksale këtu. Edhe sot kur flisni me kosovarë në Prishtinë, Pejë, Gjakovë apo Prizren dëgjoni dallime të fuqishme shoqërore dhe cilësime si “qytetarë” dhe “katundarë”. Cilësime të tilla e madje edhe shpifje mund të dëgjoreshin edhe në qarqet elitare në botën otomane të shekullit XIX. Shumica e elitës shqiptare otomane vinte nga zonat urbane të Selanikut, Janinës, Korçës. Këta njerëz i shihnin me shumë përçmim njerëzit ruralë, mbi të cilët ata shpesh ushtronin pushtet si administratorë të pushtetit otoman. Shfrytëzimi figurativ i termit “Arnavut” nga fundi i epokës otomane është i ngjashëm me shfrytëzimin e fjalës katundar sot; Isa Boletini vinte nga një pjesë e botës otomane që kishte nam të keq për “primitivizëm” dhe tradita të vrazhda. Njëkohësisht, kur pjesa e botës ku jetonte Boletini fitoi rëndësi strategjike në kuptim rajonal dhe ndërkombëtar (pas vitit 1878), ekzistenca e tij që dikur ishte margjinale u bë e një rëndësie jetike për fatin e rajonit. Regjioni i tij u bë pikë ndarëse e shteteve të ndryshme – Bullgarisë, Serbisë, Perandorisë Otomane, kështu që figurat si Boletini kishin mundësi të krijimit të aleancave politike me shumë grupe përreth. Në kohën e Boletinit, elita politike e Serbisë (Beogradit), e cila ishte e uritur për të siguruar pushtet më të gjerë dhe për të zgjeruar ndikimin komercial, ideologjik dhe politik në territoret në jug të Nishit, nuk ishte monolotike. Ata kishin parasysht një spektër të gjerë të interesave politikë dhe ekonomikë, kësaj e pranuan edhe idenë e bashkëpunimit me shqiptarët me qëllim të kundërshtimit të austrohungarezëve të cilët pas vitit 1878 kontrollonin Bosnjën e Hercegovinën, Novi Sadin dhe Novi Pazarin, si dhe të Perandorisë Otomane.

Edhe më me rëndësi është fakti se nga kontrabandimi i armëve nga Bullgaria dhe Serbia në territoret otomane fitoheshin para të mëdha, ngase grupe të çetave zhvillonin luftime sezonale kundër shtetit otoman dhe grupeve rivale. Pjesëmarrja në këtë tregti fitimprurëse të produkteve të kontrabanduara, siç janë armët, monedhat e argjendit, të mira materiale, duhani dhe drithi u mundësoi shumë njerëzve nga këto treva kufitare që të zënë vend të rëndësishëm për veten e tyre në çështjet rajonale.

Në rastin e Boletinit, ai kishte rol crucial në tregtimin e armëve dhe mallrave tjera në tërë regjionin e Mitrovicës që kufizohej me Serbinë dhe me Novi Pazarin i cili kontrollohej nga Austria. Për shkak se u konsiderua pengesë nga administrata e regjionit, ai u arrestua dhe u dërgua në ekzil në Stamboll. Ashtu siç ndodh shpesh me

njerëz që kanë pushtet në një lokalitet të caktuar, Boletinit iu ofrua “privilegji” që t’i shërbejë Sulltanit, si mënyrë për të ushtruar kontroll më të afërt mbi veprimtarinë e tij. Në fakt, ai shpejt e dëshmoi besnikërinë e tij dhe shërbeu si pjesë e regjimentit të sigurimit personal të Sulltanit, post ky që i mundësonte atij zhvillimin e marrëdhënieve me qarqet më të larta të pushtetit otoman. Në fakt, periudha që e kaloi në Stamboll mund të shpjegojë besnikërinë që Boletini dëshmoi ndaj Sulltan Abdyl Hamitit II gjatë revolucionit të vitit 1908, kur ai fillimisht i udhëhoqi trupat në konfrontimin me Komitetin për Bashkim dhe Progres (të bashkëthemeluar nga shqiptarë si Ibrahim Temo dhe Ismajl Qemajli), e më pas organizoi rezistencën kundër regjimit të xhonturqve. Në këtë kuptim, shqiptarët që jetonin në botën otomane ishin ideologjikisht të ndarë në vitin 1908, në taborin konservativ që përkrahte regjimin e vjetër që ndërliuhej me Sulltan Abdyl Hamitin II, dhe në atë të reformistëve sekularë që ishte i lidhur me Komitetin për Bashkim dhe Progres. U desh të kalonin vite të luftimeve para se të sqaroheshin se cilët interesa duhej mbrojtur pas vitit 1908. “Rezistenca” e Boletinit ndaj regjimit të ri në Stamboll duhet të vendoset në kontekst otoman dhe jo në kontekst post-otoman, në të cilin nacionalizmi shqiptar ishte faktor i ndalesës së ekspansionit serb, malazias, bullgar, italian dhe grek. E edhe periudha 1908-1912, e cila nga historiografia shqiptare gjatë është trajtuar si periudhë e ‘rezistencës nacionaliste’ ndaj ‘pushtimit’ otoman, në fakt përshkohet me luftime që garda e vjetër besnike ndaj Sulltanit të larguar nga pushteti, pjesë e së cilës ishte Boletini, i zhvillonte kundër qeverisë së re që udhëhiqej nga reformistë shqiptarë.

Gazeta: Në faqen 149 ju flisni për “gllabërimin e shpejtë të Kosovës nga trupat serbe dhe malazias në vitin 1912 dhe aneksimin brutal të më shumë se gjysmës së tokave të banuara nga gegët prej shteteve sllave”. Cilat janë arsyet kryesore për mbetjen e Kosovës jashtë shtetit shqiptar pas krijimit të Shqipërisë në vitin 1912?

I. Blumi: Ç’është më e rëndësishmja, shteti otoman i menaxhoi keq burimet e veta njerëzore dhe nuk ishte i gatshëm që të përballet me një sulm në shumë fronte në vitin 1912. Në shumë raste – gjë që nuk e shohim në librat shkollorë – komunitete të caktuara, siç ishte komuniteti i krijuar rreth Isa Boletinit dhe fqinjët e tyre bashkëpunuan me forca të jashtme, veçanërisht me Serbinë dhe Malin e Zi, me qëllim të destabilizimit të rajoneve kufitare. Më pas vijuan ndjekja dhe adaptimi nga ‘forcat moderne’ të Komitetit për Bashkim dhe Progres (shumë prej të cilëve ishin edhe ashtu shqiptarë) i metodave anti-kryengritëse që shfrytëzoheshin nga britanikët në Afrikë dhe nga gjermanët në Namibi. Pasi reformat otomane ishin në trend me ato evropiane (dhe amerikane), u shfrytëzuan armë moderne, privimi i ushqimit si mjet për të bindur popullatën, si dhe lëvizja me dhunë e popullatës gjë që i kontribuoi dobësimin të komuniteteve lokale të cilat si të tilla nuk ishin të afta që t’i kundërvihen armatës pushtuese pas fillimit të Luftërave Ballkanike. Ironik është fakti se kurrë nuk ka pasur revoltë kolektive, të përbashkët, të të gjithë shqiptarëve, por vetëm veprime individuale dhe specifike. Në raste të tilla profiti dhe oportunizmi i një grupi apo një koalicioni të vogël shpesh i shërbente interesave

më të larta të shteteve fqinje të cilat donin që ta asgjësojnë zinxhirin furnizues të shtetit otoman.

Kjo është evidente në revoltat në Malësi, të cilat shpjen tek një fushatë masive e shtypjes së kryengritjes në vitet 1910 dhe 1911 që rezultoi me shumë viktima, me shkatërrimin e komuniteteve që jetonin përgjatë kufirit si dhe me konfiskimin e armëve. Migrimet që pasuan për në Shkodër e madje edhe për në Mal të Zi (dhe burrat e shumtë të këtij regjioni që u dërguan për të shërbyer si ushtarë në Anadoll e madje edhe Jemen në vend se ta mbronin familjen e tyre, komunitetin e tyre e me këtë edhe Perandorinë Otomane) i kontribuuan dobësimit të komuniteteve lokale atëherë kur këto të fundit kishin më së shumti nevojë për ta. Në vitin 1912, në këto vise ekzistonte vetëm një popullësi e shpërndarë, kryesisht e çarmatosur dhe e ndarë, gjë që i mundësoi armatave serbe dhe malazeze pushtimin e pjesës më të madhe të Shqipërisë Veriore, Kosovës. Megjithatë, ky proces nuk do mund të realizohej aq lehtë pa njëfarë bashkëpunimi me popullatën lokale; tregimet për liderët lokalë shqiptarë të mashtruar, të cilët deri në vitet 20-ta të shekullit të kaluar “bashkëpunonin” me këta të huajë që u premtorin fonde, armatim dhe mundësi për tu ngjitur në shkallët e pushtetit në rajon tregojnë për një mallkim të përhershëm të shqiptarëve.

Gazeta: Ka shumë njerëz që inkurajojnë shtjellim më të thuktë të historisë sonë tani që lufta e Kosovës me Serbinë ka mbi një dekadë që ka përfunduar dhe u bënë mbi 2 dekada nga rënia e komunizmit në Shqipëri. Sipas jush, cilat janë korrigjimet kryesore të historisë që do duhej kryer, në mënyrë që studentët shqiptarë që mësojnë historinë të kenë perceptime më të përafërta me atë që ka ndodhur në realitet?

I. Blumi: Përveç të pranuarit dhe integritit të otomanëve në historinë tonë, shqiptarët gjithashtu duhet të miratojnë planprograme shumë më të gjera mësimore që do t'u mundësonin që të studiojnë edhe raste tjera të ngjashme në botë, që të kryejnë studime komparative të zhvillimeve në epokën e ‘modernitetit’ dhe globalizimit. Paralelet mes popujve që kanë jetuar në botën otomane dhe atyre në disa vise të Afrikës, Azisë dhe kontinentit amerikan janë thelbësore. Kjo nënkupton që shqiptarët të mësojnë gjuhë të huaja, të kuptojnë se si ngjashmëritë që kanë viset tjera të botës, për shembull Oqeani Indian dhe Amerika Latine, kanë kontribuar në proceset globale, dhe të mos fokusohen vetëm në Shqipëri apo Ballkan.

Në këtë aspekt, shqiptarët duhet të zhvillojnë një ndjenjë më të fuqishme të kompleksitetit që nuk e nënshton dinamikën e kontekstit për të ri-fuqizuar mitet për një politikë uniforme shqiptare e cila nuk ekziston as sot. Duke krahasuar përpjekjet tona për drejtësi sociale dhe ekonomike në shekullin XX me përpjekjet në Afrikë, Azi dhe kontinentin amerikan, do të jemi në gjendje të artikulojmë më mirë para të tjerëve, për shembull, përse lufta për pavarësi është e drejtë. Studentët shqiptarë (dhe mësimdhënësit e tyre) duhet të mësojnë se si shoqëritë tjera i kanë përjetuar transformimet globale gjatë dy shekujve të fundit. Kjo do të na ndihmonte që të çmojmë më mirë përpjekjet kolektive të sotme për t'u përballur me këto forca

që po ndryshojnë në mënyrë dramatike e të cilat po na shpijnë drejt varfërimit, izolimit diplomatik dhe keqpërdorimit për shkak të interesave të jashtëm (dhe të vendit). Të kuptuarit simplistik dhe sipërfaqësor të mënyrës së funksionimit të botës, në veçanti të aleatëve të Kosovës në Amerikë dhe Evropë (thujse ata mendojnë vetëm për interesat tonë), është i gabuar dhe i prapambetur. Nëse kosovarët do të kuptonin më mirë natyrën e luftës së popujve në Afrikë, Azi dhe kontinentin amerikan kundër fuqive të caktuara globale, ata do të ishin më të gatshëm për ta kuptuar të kaluarën e tyre në këtë kontekst e mbase edhe për t'iu kundërvënë forcave që vazhdojnë të pengojnë zhvillimin e kësaj shoqërie.

Gazeta: Në formë ideje, kur u formësua shteti i Kosovës? Gjithashtu, gjatë periudhës së Perandorisë Otomane sa ishin të ndara apo të përkufizuara regjionet e Kosovës dhe Shqipërisë aktuale, apo mos funksiononin ato më shumë si një entitet kompakt?

I. Blumi: Kosova nën Perandorinë Otomane mbulonte një territor tjetër gjeografik dhe kulturor nga ai që ka sot dhe si e tillë shumë pak i ngjan shtetit aktual. Mund të konsiderohet edhe ironike se si entitet modern me pretendime të mundshme për pavarësi politike dhe shoqërore, Kosova merr formën e saj moderne tek në shekullin XX, do të thotë gjatë okupimit serb. Origjina e mundshme e Kosovës si realitet politik dhe juridik mund të konsiderohet pjellë e Jugosllavisë, në të cilën nacionalistët serbë konfrontoheshin me rivalë tjerë sllavë (dhe me palët myslimane në vitet e 20ta të shekullit XIX). Me fjalë tjera, Kosova ligjërisht ekziston sot si rrjedhojë se Serbia, përkundër përpjekjeve nga elemente nacionaliste, nuk arriti ta kolonizojë atë tërësisht madje as përmes gjenocidit që kreu në territoret shqiptare pas rënies së Perandorisë Otomane. Kjo ndërlikohet ngushtë me qëndrimet që i paraqita më parë lidhur me rolin e shtetit në formësimin e identiteteve në shekullin XX; fakti se disa protagonistë të caktuar politikë insistuan në shfrytëzimin e epistemologjive raciste të viteve të 20-ta gjatë karakterizimit të marrëdhënieve mes pretendimeve nacionaliste serbe dhe popujve tjerë të Mbretërisë (atëbotë Federatës), mund të ketë ndihmuar në dallimin mes popullatës vendore të një regjioni nga hierarkia e re politike serbomalazeze të cilës i nevojitej tokë, fuqi e lirë punëtore, etj. Përgjigja në pyetjen pse Serbia nuk i realizoi plotësisht planet e saj për këmbim të popullatës është më e ndërlikuar dhe kërkon hulumtime më të thukëta jashtë binomit shqiptarë/serbë.